

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE
“H.INNOVATECH” SH.P.K**

Sot me date **08.01.2020**

- **Paolo AMICO, atesia (Emilio), shtetas italian, lindur me 19.10.1953, ne Foligno(PG) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me AY7889206.**
- **Jacopo AMICO, atesia (Paolo), shtetas italian, lindur me 09.08.2000, ne ROMA(RM)) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me nr.AZ0963578**

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA


NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date **08.01.2020**, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“H.INNOVATECH” SH.P.K

2. Themeluesit e shoqerise jane:



Jacopo Amico

3. **Paolo AMICO, atesia (Emilio), shtetas italian, lindur me 19.10.1953, ne Foligno(PG) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me AY7889206.**
4. **Jacopo AMICO, atesia (Paolo), shtetas italian, lindur me 09.08.2000, ne ROMA(RM)) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me nr.AZ0963578.**

NENI 2 OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Projektim, ndertim, shitje, import, eksport, instalim, montim, konsulence, mirembajtje dhe asistence teknike per impjantet teknologjike te posacem si: Impiante termike ajrimi dhe kondicionimi, impiante gazi, higjene, hidrosanitare, kuzhina dhe lavanderi, impiante elektrike civile dhe industriale, telefonie, radiotefonike, televizive dhe te ngjashem dhe gjithcka tjeter lidhur me sektorin e telekomunikacioneve dhe perkthime simultante, impiante citofonike, elektronike, elektro-siguri, kontroll dhe antivjedhje, kunder zjarrit, televizive edhe me qark te mbyllur dhe telematik, impiante elektronike origjinale per kerkim dhe prodhim ne fushen teknike-shkencore, menaxheriale dhe organizative si dhe per automatizimin e proceseve dhe per perpunim automatik te informacionit, duke inkorporuar aparaturat, impiante ashensori, shkalla levizese dhe transportues ne pergjithesi, impiante pneumatike, sigurie, mirembajtja e tyre. Furnizim dhe instalim i llambave me kursim energjetik, prodhimi i software-ve. Gjetja dhe realizimi i zgjidhjeve teknologjike te reja ne sektorin energjetik, suporti ne instalimin e aparaturave teknologjike te kategorise OG11 dhe OS30, konsultimi ne fushen energjetike, koordinimi, menaxhimi, asistence teknike, tregtare dhe promocionale edhe ne formen e filialit tregtar (franshize). Shitblerje dhe menaxhimi i pasurive te luajshme e te paluajshme ne territorin shqiptar dhe jashte tij, aktivitet import-eksport etj

Jacopo Amico

Blerje dhe shitje ndërtimi dhe administrimi i strukturave turistike-hoteliere, ndërtimi i ndërtesave të ndryshme industriale, socio-kulturore, civile dhe jo-civile, ndërtimi i infrastrukturës, ndërtimi i apartamenteve dhe vilave të banimit, kanalizimeve dhe furnizimit me ujë, rrugëve, materialeve të ndërtimit, rinovimit të ndërtesave dhe rindërtimi i ndërtesave eksporti civil dhe jo civil i makinerive të ndërtimit dhe të gjitha produkteve sipas aktivitetit të ndërtimit.

Prodhimi i energjisë elektrike dhe energjisë në përgjithësi, tregtia me energji elektrike dhe energji në përgjithësi, tregtimi i produkteve të energjisë, blerja e çertifikatave të energjisë siç janë çertifikatat e gjelbërta, certifikatat e bardha dhe të ngjashme; shërbime për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e impianteve me koncesion, prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë përmes kompanive të shërbimit të energjisë.

Ekzekutimi i kontratave për veprimtarinë e lartpërmendur, përfshirë furnizimin e shërbimeve, prodhimin e marketingut dhe shitjen e energjisë në format e ndryshme të tij, çertifikatat e energjisë dhe shërbimet e integruara në fushën e energjisë për kursimet dhe në emër të palëve të treta optimizimi (menaxhimi i energjisë); Cdo operacion komercial, operacione në lidhje me pronësinë dhe hipotekat e luajtshme dhe të paluajtshme në lidhje me transaksionet financiare dhe kreditë, japin garanci për palët e treta, si dhe për të blerë dhe shitur ose marrë me qira degën e biznesit të sipërmarrjes, si dhe të marrin pjesë në kompani, subjekte, konzorcione, të themeluara ose të krijuara, duke pasur të njëjtin objekt ose funksion të ngjashëm funksional për të arritur objektivat e kompanisë. Investimet në ndërtim, blerje, administrim, tregun e pasurive të paluajtshme, aktivitete me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, "Pasuri të paluajtshme".

Tregtia, shitja, import-eksporti i produkteve, materialeve të ndërtimit dhe makinerive të ndryshme thelbësore për ushtrimin e veprimtarisë. Ushtrimi i biznesit në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin.

Për të gjitha ato aktivitete që kërkojnë licenca të veçanta, ndërmarrja merr përsipër të përmbushë kërkesat e ligjeve specifike.

NENI 3 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te pacaktuar
Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

Jaques Omiceo

NENI 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II

KAPITALI

NENI 5
KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 1000 (nje mije) leke i perbere nga nje(2) kuota.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen :


- ***Paolo AMICO, atesia (Emilio), shtetas italian, lindur me19.10.1953, ne Foligno(PG) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me AY7889206, 50%***
- ***Jacopo AMICO, atesia (Paolo), shtetas italian, lindur me 09,08,2000, ne ROMA(RM) , Itali dhe banues neASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me nr.AZ0963578,50%***

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.



Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.


Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE NENI 8 ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti



Jaqueso Amico

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9 THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- n. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- o. Ndryshimet e statutit
- p. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- q. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- r. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- s. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- t. Miratimi, i bilanceve
- u. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- v. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- w. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- x. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- y. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- z. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Jaques Armies

NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, asambleja e pergjithshme do te vendose me 100% te votave te ortakeve themelues.

Cfaredo vendim-marrje do te konsiderohet e vlefshme vetem nese ortaket votojne ne unanimitet te plote.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me 100% te votave te ortakeve , per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij



Jaepo Amico

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- b) vleresmin e veprimtarise se tij
- c) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- d) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- e) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- **Paolo AMICO, atesia (Emilio), shtetas italian, lindur me 19.10.1953, ne Foligno(PG) , Itali dhe banues ne ASSISI(PG) , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti italiane me AY7889206, 50%**

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) PergatIsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurIse se veprImtarIse dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratIm
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise

Paolo Amico

- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR –EKSPERTET


NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17 EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrolltet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrolltet periodike te ushtruara.



Jaopo Omies

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.



NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare

NENI 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $3/4$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21
LEGJISLACIONI



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".


NENI 22
MOSMARRREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

(PAOLO AMICO)

A handwritten signature in blue ink, enclosed in a large blue bracket that also encompasses the name above it. The signature is stylized and difficult to read.

(GIACOMO AMICO)

A handwritten signature in blue ink, written in a cursive style. The name 'Giacomo Amico' is clearly legible.